

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin**Prill, 2020*

Takime nga larg Kuvendet Sindikale të Arsimit Parauniversitar

Dëshmi me fakte për punën dhe përkushtimin e kolegëve tanë




Stafi i SBASHK-ut që nga fillimi i procesit mësimor në distancë ka nisur me realizimin e agjendës duke komunikuar nga larg me anëtarët e Kuvendeve Sindikale të Arsimit Parauniversitar nga të gjitha komunat e Kosovës. Në të gjitha këto takime është thënë nga Kryetari dhe stafi i SBASHK-ut se çështje kyçe e këtyre takimeve është angazhimi, përkushtimi, arritjet, por edhe sfidat dhe pengesat eventuale me të cilat po takohen punëtorët e arsimit kudo në Kosovë. Kryetarët e nivelit komunal në hapje të këtyre takimeve nga larg kanë bërë prezantime të angazhimeve të kolegëve në ...(faqe 5)

SBASHK mban takim nga larg me Kryesinë e Sindikatës së Universiteteve

Punëtorët e arsimit të lartë vazhdojnë me angazhimet

Në kuadër të realizimit të agjendës së takimeve nga larg stafi i ...(faqe 7)

EI- komunikim nga larg me sindikatat nga e tërë bota

SBASHK-u –Angazhim i madh i kolegëve tanë në arsimin nga larg

Internacionalja e Arsimit, që përfaqëson 32 ...(faqe 12)

Intervistë me kryetarin e SBASHK-utRrahmanJasharaj**Jam krenuar dhe krenohem me kolegët e mi sindikalistë të arsimit***Arsimi në Kosovë që nga 13 marsi e këndeje ndodhet në një situatë ...(faqe 3)*

Situata aktuale në arsimin e Gjermanisë dhe angazhimi i sindikatës atje

Tregon kryetarja e GEW-së dhe njëra nga nënkryetarët e EI-së, znj. Marlis Tepe

SBASHK-u vazhdon komunikimin nga larg me kryetaren e sekretarin e(faqe 8)

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Si dikur edhe sot punëtorët e arsimit në krye të misionit të tyre të shenjtë



Jetës dhe kohës nuk i dihet kurrë. Gjërat ndryshojnë në pamjen e tyre, por të krijohet bindja se në situata të tilla je gjendur edhe në të kaluarën ti bashkë me kolegët e veprimtarët e një çështjeje. E them këtë ngase kjo situata e vështirë e krijuar nga Covid-19 të nxit të mendosh a jemi në një situatë të vështirë vetëm tani e në këtë kohë. Kujtesa, pa dashur ti, të kthen në vitet e 90-ta. Atëherë, situatë e rëndë e okupimit. Një armik që shihej e mbillte dhunë e vrasje kudo arrinte ishte sulur kundër gjuhës e identitetit tonë kombëtar. Ai donte ta zhbënte nga faqja e dheut Kosovën si emërtim.

Në këtë kohë plot sakrifica e sfida punëtorët e arsimit të Kosovës të organizuar në sindikatën e tyre (SBASHK) po qëndronin në krye të detyrës e në misionin e tyre për ta mbrojtur dijen e dritën kundër errësirës. Edhe atëherë kishte individë që nuk bënë punën e tyre, po mundoheshin ta ndalnin aktivitetin e veprimtarëve të SBASHK-ut, e këta veprimtarët e SBASHK-ut të përkratur nga gjithë punëtorët e arsimit dhe prindërit, mbanin procesin mësimor me shumë mund e

sakrifica, po nuk ndalonin as aktivitetet arsimore e kulturore për të dëshmuar se arsimit e kultura janë gjallë dhe si të tilla edhe do të mbesin gjatë gjithë shekujve. Edhe në vitet e okupimit në shumë komuna e gjatë gjithë muajit shkurt SBASHK-u organizonte Manifestimin Dita e Mësuesit-Festa jonë për t'i përmbysur aktivitetet arsimore e sportive pikërisht më 7 Mars në ditën e madhe të mësuesit e shkollës shqipe.

Kosova, po tani edhe e gjithë bota janë në përballje me një armik tjetër. Ky nuk vërehet e nuk shkel rëndë me këpucën e pushtuesit, por vret dhe bllokon ritmet e jetës. Ky armik e cenoi edhe shkollën, nxënësin, prindin dhe deshi të kthej errësirën e ta mposht dritën. Po, nuk po arrinë. Në Kosovë, po tani edhe kudo në botë po zhvillohet luftë e përbashkët kundër këtij armiku. Në këtë luftë tani në frontin e parë janë punëtorët e shëndetësisë, të policisë, zjarrfikësit e vullnetarët humanitar, por këtë front e bëjnë madhështor prapë punëtorët e arsimit, gjegjësisht SBASHK-u me anëtarësinë e vet. Ata me përkushtimin e tyre në realizimin e misionit të tyre të shenjtë do ta fitojnë edhe këtë betejë të dritës kundër errësirës, pavarësisht mllëfit të disa individëve pse kjo po bëhet e po ndodh. SBASHK-u vazhdon rrugëtimin në përmbushjen e kërkesave legjitime të anëtarësisë dhe në shërbim të arsimit në shtetin tonë.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimit sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +383 (0) 38/226 940



Intervista

Intervistë me kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj

Jam krenuar dhe krenohem me kolegët e mi sindikalistë të arsimit



Arsimi në Kosovë që nga 13 marsi e këndej ndodhet në një situatë të re, që u krijua nga masat e ndërmarra për parandalimin e përhapjes së Covid-19. SBASHK-u në këto 30 vitet e veprimtarisë është gjendur shpesh në situata sfiduese, por ato i ka tejkaluar me sukses falë angazhimit të stafit qendror dhe të veprimtarëve sindikal e anëtarësisë, që nga çerdhet, Arsimi Parauniversitar, Universitetet dhe institucionet e shkencës e kulturës. SBASHK-u është në angazhime të shumta edhe tani dhe po jep kontribut të lartë në rrjedhën e mbarë të mësimit në distancë dhe për këtë ka marrë edhe falënderime e përgëzime edhe nga Ministria Bajrami, por edhe nga prindër e qytetarë të shumë. Duke folur për situatën aktuale në arsim kryetari i SBASHK-ut e thotë se ishte dhe është krenar me kolegët sindikalistë të arsimit.

Arsimimi sot:

Sipas jush cila është situata aktuale në arsimin e Kosovës ?

Jasharaj:

Punëtorët e arsimit të Kosovës gjithmonë e kanë ndarë fatin me popullin nëpër vite e dekada dhe kanë qenë vazhdimisht në krye të misionit të tyre të shenjtë në mbrojtjen e dritës nga errësira. Në krye të detyrës ata ishin edhe gjatë gjithë viteve të okupimit, të tillë janë edhe sot në situatën e krijuar nga Covid-19. Ata vazhdojnë me përkushtimin dhe po realizojnë misionin e tyre. Procesi mësimor dhe rrugëtimi i nxënësve drejt njohurive të reja po realizohet suksesshëm.

Arsimimi sot:

Cilat aktivitete të SBASHK-ut në situatën e re aktuale në arsim ?

Jasharaj:

Stafi qendror i SBASHK-ut u gjend në një situatë re krijuar nga masat parandaluese kundër Covid-19, por nuk ndali angazhimet në shërbim të anëtarësisë. Po ashtu nuk kanë ndalur aktivitetet as kolegët tanë nëpër komuna e Universitete. Vazhduam angazhimet në shërbim të anëtarësisë, por u fokusuam shumë edhe në kontributin në shërbim të rrjedhës së mbarë të mësimit nga larg. Pas 13 marsit individë të pakët u munduan të krijojnë në opinion përshtypje se gjoja punëtorët e arsimit tani më po rrinë në shtëpi pa bërë gjë, por SBASHK-u arriti t'i demantojë publikisht me fakte e argumente, që i merrnim nga takimet e përditshme nga larg me kolegët tanë kudo në Kosovë. Ata pak individë e mbyllën gojën para fakteve e argumenteve për punën e përkushtuar dhe kontributin e lartë të punëtorëve të arsimit, pra të anëtarëve të SBASHK-ut , nga çerdhet , Arsimi Para universitar dhe Universitetet. Ky angazhim i anëtarëve të SBASHK-ut dhe i sindikatës sonë ishte i njohur edhe për Ministren Bajrami, me të cilën kemi komunikim të vazhdueshëm dhe ajo ka shprehur falënderimet dhe përgëzimet e saj e të MASHTI-t për angazhimin dhe kontributin e SBASHK-ut në rrjedhën e mbarë të mësimit në distancë. Për punën e përkushtimin e punëtorëve arsimor të Kosovës kemi njoftuar opinionin ehe përmes informatave në mediet, që i falënderojmë shumë për punën dhe korrektësinë.

Arsimimi sot:

SBASHK-u ka mbajtur e vazhdon të mbaj takime nga larg me anëtarësinë, cila është rrjedha e këtyre takimeve?

Jasharaj:

Po kemi mbajtur dhe vazhdojmë të mbajmë takime nga larg. Stafi qendror mban çdo ditë nga dy e më shumë takime të tilla dhe bisedon për aktualitetin duke ndarë detyra për secilin. Stafi meriton lëvdata për

angazhimin dhe ashtu si e kam thënë këtë gjë kudo në takimet nga larg me Kuvendet sindikale komunale, të Universiteteve, me Këshillin Drejtues, me kryetarët dhe me anëtarësinë e shkollave, sipas kërkesës së tyre, meriton respekt angazhimi i stafit dhe veçmas i menaxherit për financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm, që krahas shumë detyrave në SBASHK, ai koordinon me sukses edhe në mbajtjen e gjithë këtyre takimeve të shumta nga larg. Në këto takime kanë dalë edhe ide e kërkesa konkrete, të cilat kanë marrë mbështetjen e anëtarësisë dhe pastaj ato dhe i kemi adresuar te institucionet. Një nga ato ishte edhe ajo që punëtorët arsimor që kanë mbushur moshën e pensionimit të vazhdojnë me procesin mësimor nga larg. Këtë kërkesë me argumente të shumta ia kemi drejtuar Ministres bajrami dhe Kryeministrit në detyrë Kurti.

Arsimimi sot:

SBASHK-u ka respekt dhe mban komunikim edhe me kolegët sindikalistë nga Evropa dhe bota, si po realizohet kjo tani?

Jasharaj:

Po, SBASHK-u, krahas komunikimit e angazhimeve të vazhdueshme me anëtarësinë, po vazhdon komunikimin dhe Komitetin e Sindikatave të Arsimit të Evropës dhe me Internacionalen e Arsimit. Përfaqësuesit tanë kanë njoftuar me argumente në këto takime për përkushtimin e kolegëve tanë në procesin mësimor nga larg dhe për aktivitetet sindikale në shërbim të anëtarësisë. Ishim pjesë edhe e takimit nga larg organizuar nga sindikata më e madhe e arsimit të Turqisë, në të cilën morën pjesë sindikatat e arsimit nga shtetet e Ballkanit, por edhe nga shumë vende të botës. Edhe në këtë takim temë kyçe e bashkëbisedës

ishte situata aktuale në arsim dhe angazhimi i sindikatave për të dhënë kontribut të çmuar në rrjedhën e mbarë të mësimit nga larg.

Arsimimi sot:

SBASHK-u edhe në këto rrethana të vështirësuar po plotëson edhe kërkesa të tjera të anëtarësisë

Jasharaj:

Është e vërtetë. Ne po mundohemi të plotësojmë çdo kërkesë të arsyeshme të anëtarësisë brenda mundësive dhe kushteve aktuale. Bie fjala, një kërkesë e tillë ishte edhe mundësia e organizimit të trajnimeve nga larg. Kjo kërkesë u bë realitet dhe ne filluam me dy trajnime me kolegët tanë nga komuna e Novobërdës. Ky aktivitet është pritur mirë nga kolegët tanë atje dhe ata kanë shprehur gjithë respektin për punën e përkushtimin e stafit qendror dhe të trajnerëve të angazhuar në këto dy trajnime, Alban Zeneli e Atdhe Hykolli .Rezultatet dhe arritjet në këto dy trajnime kanë bërë që të shtohen kërkesat për trajnime në Prishtinë e kudo në Kosovë dhe prandaj edhe është paraparë një takim nga larg me trajnerët e licencuar për të përgatitur një agjendë të mbajtjes së trajnimeve sipas kërkesave të anëtarësisë kudo në Kosovë.

Arsimimi sot:

Çka do thoni në fund të kësaj interviste për gazetën tonë?

Jasharaj:

E kam thënë shpesh dhe me plot zemrën. Jam krenuar dhe krenohem me kolegët e mi sindikalistë të arsimit. Bashkë e në SBASHK do të vazhdojmë me angazhimet dhe bashkërisht do të marrim vendime për aktivitetet dhe me unitetin e besimin e ndërsjellë që kemi do të dalim gjithmonë faqebardhë.


Gjatë muajit

Takime nga larg Kuvendet Sindikale të Arsimit Parauniversitar


Dëshmi me fakte për punën dhe përkushtimin e kolegëve tanë

Stafi i SBASHK-ut që nga fillimi i procesit mësimor në distancë ka nisur me realizimin e agjendës duke komunikuar nga larg me anëtarët e Kuvendeve Sindikale të Arsimit parauniversitar nga të gjitha komunat e Kosovës. Në të gjitha këto takime është thënë nga Kryetari dhe stafi i SBASHK-ut se çështje kyçe e këtyre takimeve është angazhimi, përkushtimi, arritjet, por edhe sfidat dhe pengesat eventuale me të cilat po takohen punëtorët e arsimit kudo në Kosovë. Kryetarët e nivelit komunal në hapje të këtyre takimeve nga larg kanë bërë prezantime të angazhimeve të kolegëve në rrjedhën e mbarë të procesit arsimor në distancë. Ata që të gjithë kanë deklaruar e kanë ofruar argumente se vërtetë kolegët tanë nga të gjitha shkollat e Kosovës janë duke punuar me zell në procesin mësimor dhe janë duke mbajtur komunikim me prindërit dhe nxënësit.

përdorë vajberin, por në shumicën e rasteve edhe platformat gjegjëse për komunikim.



Kryetari i SBASHK-ut duke marrë pjesë në të gjitha këto takime ka përgëzuar punëtorët arsimor për përkushtimin dhe pastaj edhe ka dhënë informacione të angazhimeve të shumta të stafit qendror duke falënderuar ata për përkushtimin. Kryetari Jasharaj ka shprehur lëvdata veçmas për menaxherin për financa e administratë e koordinator për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, i cili krahas shumë angazhimeve tjera, po kontribuon edhe në realizimin e aktiviteteve tjera dhe të takimeve nga larg.











Në bashkëbisedën e zhvilluar në gjitha këto takime kryetarët e shoqatave sindikale kanë raportuar se kolegët nga shkollat që përfaqësojnë ata që nga fillimi janë angazhuar në realizimin e mësimin nga larg duke


Në këto takime pjesëmarrësit kanë shtruar pyetje nga sfera e angazhimeve sindikale dhe të përvojave nga komunat për mësimin nga larg. Duke u përgjigjur në këto pyetje janë inkuadruar në bashkëbiseda nënkryetarja Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri. Nga çështjet e shtrura në këtë pjesë të takimeve ka qenë puna e Komisionit të SBASHK-ut për përgatitjen e draftit të parë të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës. Nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala ka treguar se Komisioni ka punuar vazhdimisht dhe ka përgatitur draftin e parë të Kontratës dhe se ajo u është dërguar në adresat

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

elektronike kryetarëve të nivelit komunal dhe të Universiteteve, të cilët atë do ta shqyrtojnë bashkë me kolegët tanë kudo në institucionet arsimore dhe propozimet e tyre pastaj do të analizohen nga Komisioni në mënyrë që të përgatitet drafti final, që do të negociohet pastaj mes MASHTI-t dhe SBASHK-ut për t'u nënshkruar pastaj nga të dy palët.


Krahas takimeve me Kuvendet e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve, SBASHK-u ka ngritur idenë që të mbahen takime edhe me kolegët tanë kudo në shkollat e Kosovës. Një takim i tillë është mbajtur me kolegët tanë në shkollën "Emin Duraku" te Kaçanikut. kryetari i Shoqatës sindikale të SHFMU "Emin Duraku", Lulzim Koxha, i cili ka falënderuar stafin qendror të SBASHK-ut për angazhimet dhe përkushtimin në shërbim të anëtarësisë. Ai pastaj ka deklaruar se edhe në këtë shkollë punëtorët e arsimit po angazhohen maksimalisht në realizimin e procesit mësimor nga larg.





Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri janë përgjigjur edhe në pyetjet që kanë të bëjnë me Ligjin e pagave. Ata kanë treguar se SBASHK-u ka marrë përgjigje nga Kushtetuesja lidhur me kërkesat e anëtarësisë sonë për heqjen e pezullimit ndaj këtij ligji. SBASHK-u në takime me institucionet ua ka bërë me dije e me të nisur së implementuari ky ligj do të kërkohej që pjesa shtesë që sjell ky Ligj të jepet që nga dhjetori i vitit të kaluar. Ata kanë shtuar se me të nisur

se implementuari ky Ligj SBASHK-u do të vazhdojë komunikimin me Komisionin Parlamentar për Arsim dhe me gjithë deputetët me qëllim që ata ta ngritin çështjen dhe të realizohet kërkesa e mësuesve për përmirësimin e koeficientit për ta.



Ata janë shprehur në emër të stafit qendror se ndjehen krenar me anëtarësinë, që është kaq unike dhe e përkushtuar duke premtuar se do të vazhdojnë të jenë zëri i tyre .


SBASHK mban takim nga larg me Kryesinë e Sindikatës së Universiteteve Punëtorët e arsimit të lartë vazhdojnë me angazhimet

Në kuadër të realizimit të agjendës së takimeve nga larg stafi i SBASHK-ut bashkë me kryetarin e Kuvendit të Sindikatës së Universiteteve të Kosovës, Bardh Bardhi kanë organizuar takim nga larg me përfaqësuesit sindikal të gjithë institucioneve të arsimit të lartë të shtetit tonë.




“Janë zhvilluar aktivitete të shumta sindikale në Universitete dhe po ashtu edhe ligjëratat dhe angazhimet tjera me studentët kanë rrjedhë të mbarë dhe vërehet një angazhim e përkushtim i vazhdueshëm i personelit arsimor në këto institucione të arsimit të lartë në Kosovë” ka thënë në hapje të këtij takimi

kryetari i Sindikatës së Universiteteve të Kosovës (SUSHK) në kuadër të SBASHK-ut, Bardh Bardhi. Ai pastaj ka përshëndetur kryetarin Jasharaj, stafin qendror dhe kryesinë e SUSHK-ut, që janë përfaqësuesit nga Universitetet publike të Kosovës. Pjesëmarrësit kanë shprehur respekt për angazhimet e kryetarit, stafit qendror, kryesisë dhe organeve të tjera të SBASHK-ut në realizimin e objektivave dhe kërkesave të anëtarësisë nga të gjitha nivelet arsimit në Kosovë.



Për rrjedhën e mbarë kanë folur kryetarët e nderuar të Kuvendeve Sindikale të Universitetit të Prishtinës, Gjakovës, Mitrovicës, Ferizajt, Prizrenit e Gjilanit.

Në këtë takim është zhvilluar bashkëbisedë edhe për Kontratën e re Kolektive të Arsimit të Kosovës. Lidhur me punën që ka bërë komisioni ka treguar edhe nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala, e cila ka thënë se Komisioni ka bërë mjaft angazhime dhe tani pret që nga kolegët tanë kudo në Kosovë të vijnë ide e propozime, që do të analizohen me kujdes.



Situata aktuale në arsimin e Gjermanisë dhe angazhimi i sindikatës atje

Tregon kryetarja e GEW-së dhe njëra nga nënkryetarët e EI-së, znj. Marlis Tepe

SBASHK-u vazhdon komunikimin nga larg me kryetaren e sekretarin e përgjithshëm të Internacionales së Arsimit, me kryetaren dhe drejtoreshën ekzekutive të Komitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, me udhëheqës sindikal të sindikatës gjermane, slovene të arsimit e të sindikatave nga shtete të tjera për të informuar për situatën aktuale në arsimin tonë dhe për angazhimet dhe kontributin e lartë të SBASHK-ut në zhvillimin e mësimin nga larg.

Kështu duke vazhduar me këtë komunikim SBASHK-u ka informuar për gjendjen aktuale në arsimin tonë dhe për aktivitetet dhe përkushtimin e punëtorëve arsimor edhe kryetaren e Sindikatës Gjermane të Arsimimit(GEW),znj. Marlis Tepe, që është edhe nënkryetare e EI-së, dhe stafin udhëheqës të kësaj sindikate mike. Ata, edhe një herë kanë falënderuar SBASHK-un për bashkëpunimin duke na përgëzuar për angazhimin dhe përkushtimin maksimal në shërbim të anëtarësisë dhe të rrjedhës së mbarë të mësimin nga larg. Kryetarja Tepe ka bërë një analizë të gjendjes në arsimin gjerman në situatën e masave kundër përhapjes së pandemisë në këtë shtet dhe atë e ka ndarë me anëtarësinë e sindikatës, që drejton. Duke qenë të sigurt se lexuesve tanë të shumë të intereson të dinë më shumë për gjendjen aktuale në arsimin gjerman dhe për angazhimet e sindikatës së arsimit atje me GEW-n jemi pajtuar që këtë intervistë të

kryetares Tepe ta përcjellim përmes gazetës “Arsimimi sot” edhe te anëtarësia jonë.



Kriza me Koronen dhe Rihapja e Shkollave në Gjermani

Intervistë me Marlis Tepe, kryetare e sindikatës gjermane të arsimit (GEW)

23prill 2020

Interviewees: Sigrid Thomsen

Cili është konkluzioni juaj pas pesë javësh izolimi: si janë përballur me mbylljen e shkollave punëtorët e arsimit - si nga pikëpamja e të ardhurave ashtu edhe nga pikëpamja e punës?

Shumica e mësimdhënësve në Gjermani janë punonjës të shtetit, ata janë paguar gjatë gjithë kohës, gjithashtu edhe mësimdhënësit me kontrata të përhershme pune që paguhet sipas marrëveshjeve të kontratave kolektive. Poashtu ne nuk kemi dëgjuar

për probleme për kolegët me kontrata me afat të caktuar. Pra, mësimdhënësit dalin mirë në drejtim të të ardhurave.

Sidoqoftë, në kopshtet e fëmijëve ka plane për punë me kohë të shkurtër dhe pagesa me kohë të shkurtër në disa raste, kjo është ajo që ne luftojmë aktualisht. Sidoqoftë, punonjësit e kopshteve komunale paguhen. Për ata që janë duke punuar në arsimim dhe trajnim të mëtutjeshëm, është më e vështirë sepse paguhen nga honoraria. Ne kemi arritur që ata të kenë qasje në grante sociale tani. Për studentët, afati për pagimin e granteve do të zgjatet me një mandat.

Ligjëruesit që japin mësim mbi kontratat ende punojnë në kushte të pasigurta. Në varësi të vendit ku ata punojnë, ata kanë qasje të ndryshme në masat e ndryshme të përkrahjes materiale në shtetet e ndryshme federale. Kjo pabarazi është një nga mangësitë e sistemit tonë federal.

Si e menaxhuan mësimdhënësit sfidën në drejtim të metodave të mësimdhënies në distancë?

Kjo ishte më dramatike. Gjatë takimit tonë me të gjithë administratorët federal të arsimit të shtetit më 12 Mars, vetëm Bavaria dëshironte të mbyllte shkollat. Konsultimi me ekspertë të viruseve më pas bëri që politikanët të ndryshojnë pozicionin e tyre në të njëjtën mbrëmje dhe të zgjedhin mbylljen në një njoftim shumë të shkurtër vonë të Premten e 13 Marsit. Për parashikimin e mbylljes, shumë mësimdhënës u kërkuan nxënësve/studentëve të tyre që të merrnin librat dhe letrat e tyre në shtëpi atë të Premte. Të tjerët shkuan në shkollë të hënën në vijim dhe u dërguan parcelat nxënësve të tyre me materialin e nevojshëm.

Ndryshimi në metodat digjitale ishte një sfidë. Ishte më e lehtë në ato shkolla të cilat tashmë kishin platforma për mësimin elektronik. Sidoqoftë, shumë nxënës/studentë kanë vetëm telefon celular dhe nuk mund të menaxhojnë detyrat e tyre pa laptop ose kompjuter personal. Shumë shkolla dhe mësimdhënës kanë qenë shumë kreativ duke incizuar dhe dërguar mësimet dhe duke kontaktuar me nxënësit e tyre, gjithashtu përmes telefonit. Për ne u bë e qartë se ekzistojnë mjaft shanse në mësimin digjital, por ekziston ende një nevojë urgjente për kontakt personal, veçanërisht për nxënës të rinj që nuk mund të lexojnë akoma.

Si u përballën studentët/nxënësit me këtë kohë mësi në distancë?

Kjo ndryshon për sa i përket sfondit të tyre shoqëror. Në rrethana të vështira me shtëpi shumë të ngushta, abuzimi me alkoolin dhe dhunën, ishte shumë e vështirë për nxënësit, sipas raporteve të mësuesve të tyre, të cilët ndonjëherë kishin njohuri të para në këtë situatë. Fëmijët nga shtëpitë e varfra ishin qartë të pafavorizuar. U bë e qartë se në fund të kësaj krize, na duhen më shumë masa për ta kompensuar këtë. Si sindikatë, ne kemi kërkuar mbështetje shtesë për shkollat në disavantazhe sociale, shumë kohë më parë. Gjithashtu, mësimdhënësit e tyre kanë nevojë për më pak detyra mësimore dhe më shumë kohë për bashkëveprim shoqëror.

A ka ndonjë përfitim për mësimdhënësit nga kjo periudhë për mësimet e tyre kur shkollat po rihapen në maj?

Kolegët tanë kanë bashkëpunuar me programet e tyre digjitale në shumë shkolla, ata kanë ndarë konceptet dhe videot e tyre digjitale. Disa janë më të vetëdijshëm tani për aspektet pozitive të të mësuarit digjital. Të tjerë zbuluan se disa nga nxënësit e tyre që normalisht janë të vështirë të motivohen ishin edhe më të interesuar të mësonin në këtë mënyrë. Ndërsa kufizimet shoqërore dhe izolimi zbatoheshin për të gjithë, kishte edhe më shumë kohë për të mësuar kur nuk ndodhte asgjë tjetër.

Si duket plani tani për rihapjen graduale të shkollave dhe si ndikoi GEW në të?

Rihapja e shkollave nga 4 maji është një vendim i kancelarit dhe krerëve të shteteve federale. Kjo datë është e rëndësishme për ato shtete federale që fillojnë pushimet e tyre verore më herët këtë vit, kjo vlen për ato në veri dhe Berlin, gjithashtu Rhine-Westphalia të Veriut. Ata duan që studentët e moshuar të kthehen madje edhe nga Earlierto, të sigurohen që ata të përfundojnë provimet përfundimtare para se të fillojnë festat. Si sindikatë, ne u përpoqëm të ndryshojmë faktin se aq shumë vëmendje i kushtohet provimeve; ne argumentuam se në të gjitha shtetet federale rihapjes së shkollave i duhet kohë për përgatitje. Tani fillimi do të jetë i ndryshëm nga rajoni në rajon. Përfaqësuesit rajonalë të GEW janë pjesë e ekipeve të menaxhimit të krizave vetëm në

disa nga shtetet federale, në të tjerat ata nuk këshillohen fare. Në nivelin kombëtar, presidenti i komitetit të ministrave të arsimit të 16 shteteve federale në Gjermani ka ftuar GEW dhe shoqatën e mësuesve VBE së bashku me përfaqësuesit e prindërve të shteteve federale për të dhënë përvijën e tyre vetëm tani, përpara se shkollat të rihapen.

Cilat kushte duhet të përmbushen për të mbrojtur shëndetin e mësimeve kur shkollat po rihapen?

Ne mendojmë se secila shkollë ka nevojë për një vlerësim të duhur të vendeve të punës për sa i përket kushteve sanitare dhe gjithashtu një kontroll nëse mund të mbahet distanca e nevojshme prej 1,5 metrash. Organet përfaqësuese të mësuesve në shkolla duhet të këshillohen në këto vlerësime të rrezikut: a ka mjaft pajisje për larje, sapun, lëng dezinfektimi. Shkollë më shkollë, ata duhet të vendosin se cilat grup moshë mund të kthehen së pari, kush nga personeli është i gatshëm për mësime dhe kush i përket një grupi me një rrezik më të lartë të infeksionit siç përcaktohet nga ekspertët. Ata do të ishin ata që do të vazhdojnë të punojnë nga shtëpia. Shkollat gjithashtu duhet të hartojnë një plan se si të organizojnë mësime me vetëm gjysmën e studentëve të pranishëm. Kjo është shumë komplekse.

A mendoni se mësuesit dhe nxënësit kanë nevojë për ndonjë pajisje mbrojtëse?

Sipas standardeve të ministrisë së punës të botuar në prill, ata duhet të mbajnë maska në korridore, nëse është e pamundur të mbash distancën e caktuar, për shembull gjatë pushimeve dhe çdo herë që hyjnë ose dalin nga ndërtesa. Sidoqoftë, edhe maskat mund të bëhen një rrezik nëse nuk përdoren siç duhet. Këto konsiderata duhet t'i lihen secilës shkollë individualisht. Nga këndvështrimi ynë, është problematike që në kaq shumë shkolla nuk kemi komitete përgjegjëse për sigurinë dhe sigurimin në punë. Kohë më parë kemi kritikuar se siguria dhe siguri në punë është lënë pas dore në shkollat publike. Tani zyrtarisht për shëndet publik do të duhet të bëhen aktive për të kontrolluar dhe dhënë këshilla për shkollat.

Çfarë do të thotë për mësuesit që të organizojnë mësime/ligjëratat e tyre si ndërrime?

Ata do të duhet të përgatisin të dy mënyrat: mësime për gjysmën e studentëve që janë prezent, dhe detyra për ata që po mësojnë në shtëpi në të njëjtën kohë. Duhet të vendoset se çfarë ka më shumë kuptim: të keni një grup në shkollë për tre orët e para të mëngjesit dhe grupin tjetër për tre orët e fundit, ose t'i bëni ata të ndryshojnë ndërrime në baza ditore ose javore. Sidoqoftë, do të jetë mjaft sfidë të krijoni një tryezë kohore dhe të koordinoni atë sistem me praninë e kolegëve. Duhet gjithashtu kohë për planifikimin e duhur. Për më tepër, të gjitha këto aspekte duhet të koordinohen me shërbimet e transportit shkollor.

Cilat duhet të jenë kushtet e provimeve në shkolla tani?

Ne mendojmë se nuk duhet të ketë provime në shkolla këtë vit për shkak të shanseve shumë të pabarabarta për t'u përgatitur nga ana e nxënësve. Përkundrazi, ata duhet të marrin një certifikatë përfundimtare sipas performancës së tyre para mbylljes së shkollave, duke pranuar atë që kanë bërë deri tani - ashtu si vendet e tjera në Evropë e bëjnë atë. Nga këndvështrimi ynë, vendimi për të zbatuar provimet tani është një përqendrim i papërshtatshëm për ata studentë që bëjnë matricën. Ajo rrit dallimet rajonale dhe nuk u kushton vëmendje të tjerëve.

Si i ka mbështet dhe si i mbështet GEW anëtarët e saj në këtë proces?

Ne kemi krijuar një faqe në internet që i përgjigjet shumë pyetjeve rreth pandemisë së koronës, dhe ju kemi drejtuar politikanëve në të gjitha nivelet e qeverisë në Gjermani në emër të tyre. Ne madje kemi biseduar me ministrat e punës dhe financave për të sqaruar nevojat financiare. Ne iu afruam edhe ministrit të bashkëpunimit dhe zhvillimit ekonomik, Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar. Të gjitha qeniet njerëzore në të gjithë botën preken nga virusi korona. Kjo është gjithashtu e vërtetë për refugjatët: Ne avokojmë për zhvendosje nga kampe ku nuk mund të mbahen kushte të mira sanitare. Solidariteti dhe të drejtat e njeriut janë ndërkombëtare.

Corona Crisis and School Reopening in Germany

Interview with Marlis Tepe, president of the German education union (GEW)

23rd of April 2020

Interviewer: Sigrid Thomsen

What is your conclusion after five weeks of lockdown: how did education workers get through the closing of schools - income-wise and also workwise?

Most teachers in Germany are state employees, they were paid all through, also teachers with permanent working contracts who are paid according to collective bargaining agreements. We also haven't heard of problems for colleagues with fixed-term contracts. So, teachers come out alright in terms of income.

In kindergartens, however, there are plans for short time work and short time pay in some cases, that is what we fight presently. However, employees of municipal kindergartens are paid through.

For those who are working in further education and training, it is more difficult because they are paid by honoraria. We have achieved that they have access to social grants now. For the students, the time limit for the payment of grants will be extended by one term.

Lecturers who are teaching on contracts still work under precarious conditions. Dependent on where they work, they have different access to the varying short-term material support measures in the different federal states. This inequality is one of the shortcomings of our federal system.

How did teachers manage the challenge in terms of distant teaching methods?

That was more dramatic. During our meeting with all federal state education ministers on 12th of March, only Bavaria wanted to close schools. Consultation with virus experts then made the politicians change their position on the same evening and opt for closure on very short notice late on Friday 13th of March. Anticipating the closure, many teachers asked their students to take their books

and papers home that Friday. Others went to school the following Monday and sent parcels to their pupils with the material they needed.

Changing to digital methods was a challenge. It was easier in schools which already had platforms for e-learning. However, many students only have mobile phones and could not manage their tasks without laptops or personal computers. Many schools and teachers have been very creative in recording and sending lessons and contacting their students, also by telephone. For us it became clear that there are quite some chances in digital learning, but there is still an urgent need for personal contact, specifically for the younger pupils who cannot read yet.

How did the students cope with this time of distant learning?

That varies in terms of their social background. In difficult circumstances with very narrow homes, alcohol abuse and violence, it was very hard for learners, according to their [teachers' reports](#) who sometimes had first insights in this situation. Children from poor homes were clearly disadvantaged. It became obvious that at the end of this crisis, we need more measures to compensate for this. As a union, we have demanded additional support for schools in socially disadvantaged areas long ago. Also, their teachers need less teaching duties and more time for social interaction.

Is there any gain for teachers from this period for their lessons when schools are re-opening in May?

Our colleagues have cooperated with their digital programmes in many schools, they shared their digital concepts and videos. Some are more aware now about the positive aspects of digital learning. Others discovered that some of their pupils who are normally difficult to motivate were even more interested in learning this way. As social restrictions and isolation applied to everyone, there was also more time for learning when nothing else happened.

How does the plan now for the gradual re-opening of schools look like, and how did GEW influence it?

Re-opening schools from 4th of May is a decision by the chancellor and the heads of the federal states. This date is important for those federal states who

start their summer holidays early this year, that applies to those in the North and Berlin, also North Rhine-Westphalia. They want the elder students back even earlier to make sure that they finish the final examinations before the holidays begin. As a union, we tried to change the fact that so much attention is paid to the examinations; we argued that in all federal states the re-opening of schools needs time for preparation. Now the starting will be different from region to region. Regional representatives of GEW are part of the crisis management teams only in some of the federal states, in others they are not consulted at all. At the national level, the president of the committee of the education ministers of the 16 federal states in Germany has invited GEW and the teachers' association VBE together with the federal parents' representatives to give their expertise only now, before the schools will re-open.

What conditions should be met to protect teachers' health when the schools are re-opening?

We think that each and every school needs a proper assessment of the working places in terms of the sanitary conditions and also a check if the necessary distance of 1,5 meters can be kept. Representative bodies of teachers in the schools should be consulted in these danger assessments: is there enough washing facilities, soap, disinfection liquid. School by school, they need to decide which age groups can come back first, who of the staff is ready for teaching and who belongs to a group with a higher risk of infection as defined by the experts. Those would be the ones to continue working from home. Schools also need to [make a plan](#) how to organise lessons with only half of the students present. This is very complex.

Do you think teachers and students need any protective equipment?

According to the standards of the ministry of labour published in April, they might have to wear masks on the corridors if it is impossible to keep the prescribed distance, for example during the breaks and each time they enter or leave the building. However, even masks can become a risk if not properly used. These considerations should be left to each and every individual school. From our point of view, it is problematic that in so many schools you don't have committees responsible for safety and security at work. Long ago we criticised

that safety and security at work has been neglected in public schools. Now the offices for public health will have to become active to check and give advice to the schools.

What does it mean to the teachers to organise their lessons like shifts?

They will have to prepare both ways: lessons for half of the students who are present, and tasks for those who are learning at home at the same time. It has to be decided what makes more sense: to have the one group in school for the first three hours of the morning and the other group for the last three hours, or to have them change shifts on a daily or weekly base. However, it will be quite a challenge to make a time table and coordinate that system with the presence of the colleagues. It also needs time for proper planning. Additionally, all these aspects have to be coordinated with school transport services.

What should be the conditions for examinations in schools now?

We think that there shouldn't be examinations in schools this year because of the very unequal chances for preparing on the side of the students. Instead, they should get a final certificate according to their performance before the closing of schools, acknowledging what they have done so far – just as other countries in Europe do it. From our perspective, the decision to enforce examinations now is an inappropriate focus on those students who do the matric. It increases regional differences and does not pay attention to others.


How did and how does GEW support its members in this process?

We have developed a homepage which responds to many questions around the corona pandemic, and we have addressed politicians at all levels of government in Germany on their behalf. We even spoke to the ministers of labour and of finances to clarify the financial needs. We also approached the minister of economic cooperation and development, the World Bank and the International Monetary Fund. All human beings worldwide are affected by the corona virus. This is also true for refugees: We advocate for relocation from camps where good sanitary conditions cannot be kept. Solidarity and human rights are international.

EI- komunikim nga larg me sindikatat nga e tërë bota

SBASHK-u –Angazhim i madh i kolegëve tanë në arsimin nga larg

Internacionalja e Arsimit, që përfaqëson 32 milionë punëtorë të arsimit nga e tërë bota ka vazhduar komunikimin me sindikatat anëtare duke i inkurajuar për punë e angazhime edhe në këtë situatë të vështirësuar nga përhapja kudo në botë e Covid-19. Në kuadër të këtij angazhimi sekretari i përgjithshëm i EI-së, David Edvards ka mbajtur një takim nga larg me përfaqësues të sindikatave anëtare.




Në hapje të këtij takimi sekretari përgjithshëm i EI-së, z. Edvards ka bërë një raportim për gjendjen dhe situatën e krijuar nga virusi Covid-19. Ai ka përgëzuar punëtorët e arsimit për angazhimin e përkushtimin që ta realizojnë misionin e tyre të shenjtë edhe në këto kohë mjaft të vështira e duke u përballur me sfida të shumta.


“Internacionalja e Arsimit po përcjell me vëmendje situatën aktuale dhe qëndron në mbështetje të kolegëve kudo në botë, të cilët po angazhohen me tërë mundësitë për të realizuar sa më mirë procesin mësimor nga larg”, ka deklaruar Edvards.

”Respekt për EI-në dhe në veçanti për sekretarin e përgjithshëm Edvards, që edhe në këtë situatë kur e gjithë bota është e ballafaquar në luftën kundër Covid-19, na ka lidhur përmes kësaj platforme që ne po prezantojmë situatën në vendet tona, por gjithashtu po marrim këshilla dhe përvojë me vlerë. SBASHK çdo ditë mban takime nga distanca me mësimdhënës, me psikologë nga e gjithë Kosova për të bashkëbiseduar në përpjekjet e përbashkëta për suksese sa më të mëdha. Punëtorët e arsimit të Kosovës janë të përkushtuar në realizimin e mësimin nga larg dhe për këtë kanë edhe mbështetjen e

SBASHK-ut dhe në shërbim të arritjeve sa më të mëdha organizojmë vazhdimisht takime nga larg me kolegët tanë duke u dhënë mbështetje dhe duke i përgëzuar për angazhimet e tyre.” janë shprehur përfaqësuesit e SBASHK-ut duke qenë pjesë e këtij aktiviteti nga larg të EI-së.



Pjesëmarrësit e këtij takimi të rëndësishëm nga sindikatat e arsimit nga e tërë bota janë shprehur se edhe në momente tepër të vështira është më lehtë të veprohet në shërbim të arsimit dhe sindikalizmit kur ka unitet dhe solidaritet mes kolegëve nga të gjitha shtetet e botës.






Në vazhden e angazhimeve dhe komunikimit nga larg me kolegët tanë kudo në Ballkan e botë përfaqësues të SBASHK-ut kanë marrë pjesë edhe në Konferencën nga larg, organizuar nga sindikata më e madhe e arsimit të Turqisë, Egitim-Bir –Sen. Kryetari i SBASHK-ut duke u kyçur në debatin e kësaj Konference ka treguar për përkushtimin e punëtorëve të arsimit dhe për angazhimet e SBASHK-ut duke kontribuar në rrjedhën e mbarë të mësimin në distancë. Ai ka deklaruar se kjo sindikatë ka bashkëpunim të mirë me MASHTI-n.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Ai pastaj ka treguar se Ministria ka angazhuar një numër të caktuar të mësimdhënësve për xhirimin e njësive mësimore në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhën e komuniteteve, të cilat emitohen në Televizionin publik. Kryetari Jasharaj po ashtu ka treguar se SBASHK-u po mban vazhdimisht takime nga larg me Kuvendet sindikale komunale dhe të Universiteteve dhe po inkurajon punëtorët e arsimit që të vazhdojnë me angazhimin dhe përkushtimin. Ai ka vlerësuar lart punën e punëtorëve të arsimit kudo në Kosovë dhe aktivitetet e angazhimit e vazhdueshme të SBASHK-ut edhe në këtë situatë, duke cekur se, krahas gjithë këtij angazhimi e duke respektuar vullnetin dhe kërkesat e anëtarësisë, po mbahen edhe trajnime nga larg. Edhe përfaqësuesi i Sindikatës shqiptare të Shqipërisë, Arian Peraj, sikur edhe

kolegët e tij nga shtete të tjera kanë treguar për situatën në shtetet e tyre dhe për përpjekjet e punëtorëve të arsimit atje në realizimin e mësimin nga larg duke përmendur edhe vështirësitë që shoqërojnë këtë proces.




Dy trajnime nga larg me kolegët tanë nga komuna e Novobërdës Kolegët nga kjo komunë e Kosovës me SBASHK-un në angazhime të reja



Krahas bashkëbisedave për mësimin në distancë në takimet nga larg me kolegët tanë kudo në komunat e Kosovës, kryetari Jasharaj dhe stafi qendror kishte treguar për gatishmërinë që edhe në këtë situatë të krijuar nga Covid 19, nëse anëtarësia shpreh kërkesa për trajnime, ky aktivitet do të organizohet nga larg. Ky premtim u bë realitet duke realizuar dy kërkesa të


kolegëve tanë nga komuna e Novobërdës. Trajnimi i parë i organizuar për ta nga SBASHK-u ishte "Edukimi Medial dhe Roli i tij në Zhvillimin Shoqëror dhe Demokratik" që është udhëhequr nga profesori i nderuar nga Departamenti i Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, Alban Zeneli.



Edhe në këto aktivitete nuk ka munguar kryetari i SBASHK-ut dhe stafi qendror. Në nisje të trajnimit për edukimin medial „por edhe në trajnimin tjetër "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm", udhëhequr nga trajneri Atdhe Hykolli, ligjërues në Fakultetin e Edukimit, kryetari Jasharaj ka uruar pjesëmarrësit dhe ka falënderuar për gatishmërinë e angazhimit të dy trajnerët e nderuar. Ai ka përgëzuar kryetarin e sindikatës sonë për Novobërdën, Besnik Kurteshi dhe kolegët tanë në këtë komunë për përkushtimin dhe unitetin. Kryetari Jasharaj në komunikim nga larg me pjesëmarrësit e të dy trajnimeve ka shprehur respekt për angazhimet e stafit qendror në shërbim të anëtarësisë duke falënderuar Ymer Ymerin, që krahas angazhimeve të shumta, po angazhohet pa u ndalur edhe për organizimin në nivel të aktiviteteve sindikale.

Kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Para universitar për këtë komunë, Besnik Kurteshi ka falënderuar SBASHK-un, që si tha ai, po bën gjithë angazhimet në shërbim të anëtarësisë dhe kjo ka bërë që anëtarësia nga kjo komunë të jetë unike dhe e

përkushtuar në shërbim të arsimit, por edhe duke dhënë kontribut në unitetin dhe arritjet e SBASHK-ut. Në kuadër të këtyre trajnimeve janë zhvilluar edhe bashkëbiseda me stafin qendror të SBASHK-ut lidhur me aktivitetet konkrete sindikale.



Takim nga larg me kryetarët e nivelit Komunal sindikal dhe të Universiteteve


Bashkërisht e unik në të gjitha angazhimet në shërbim të anëtarësisë




Me qëllim të komunikimit e bartjes me kohë të gjithë informacioneve, SBASHK-u ka organizuar takime të vazhdueshme konsultative nga larg me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve.

Në këto takime kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka përgëzuar kryetarët për angazhimet, kolegët kudo janë për përkushtimin në rrjedhën e mbarë të mësimit në distancë dhe stafin për gjithë arritjet. Ai ka informuar po ashtu edhe për komunikimin e vazhdueshëm me MASHTI-n dhe për informimin për gjithë aktivitetet dhe veçmas për angazhimin e përkushtuar të anëtarësisë sonë në

realizimin e procesit mësimor nga larg. Ai po ashtu ka informuar kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve edhe me kërkesën, që fillimisht ia kishte dërguar Ministres Bajrami, lidhur me nxjerrjen e një vendimi që do ua mundësonte kolegëve tanë, që kanë ardhur në moshën e pensionimit, që të vazhdojnë punën në procesin mësimor nga larg deri sa të kalojë kjo situata aktuale në vendin tonë. Një shkresë me kërkesën e tillë SBASHK-u i ka drejtuar po ashtu Kryeministrit Kurti dhe pritet përgjigja nga ai.





Në një takim tjetër konsultativ me kryetarët e Kuvendeve komunale sindikale dhe të Universiteteve është vazhduar komunikimi dhe vlerësimi për rrjedhën e procesit mësimor e ligjëratave dhe për angazhimet aktuale sindikale. Pas kësaj kryetari Jasharaj ka deklaruar se në këtë takim do të bashkëbisedojmë për rrjedhën e procesit mësimor dhe ligjëratave nga larg, por edhe për shqetësimet që mund të jenë ngritur nga kolegët tanë për


cilën do çështje. Të pranishmit në këtë takim i ka përshëndetur duke i përgëzuar për gjithë angazhimet edhe nënkryetari i BSPK-së, prof. dr. Atdhe Hykolli. Ai ka shprehur respekt për punën e përkushtimitin e gjithë punëtorëve arsimor për realizimin e procesit mësimor në distancë. Ai ka lavdëruar stafin qendror të SBASHK-ut.





Kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Malishevës, Skënder Gashi ka prezantuar shqetësimet e ngritura nga kolegët tanë nga kjo komunë lidhur me një lajm të plasuar aty e këtu se mund të ketë ulje pagash për të punësuarit në sektorin e arsimit dhe në shërbimet tjera publike. Lidhur me këtë është zhvilluar një bashkëbisedë me pjesëmarrësit duke qenë vlerësim i përbashkët se ky lajm i plasuar nuk ka bazë

në as edhe një argument e vendim eventual të institucioneve dhe se SBASHK-u është duke përcjellë me kujdes situatën dhe bashkërisht e me marrëveshje unike, si gjithmonë, do të veprojë ashtu si e kërkon situata dhe ashtu si vendoset në mënyrë unanime nga përfaqësuesit e punëtorëve të arsimit, gjegjësisht

anëtarësisë së SBASHK-ut. Menaxheri për financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri është shprehur se vet Ministri në shkuarje i financave ka demantuar lajmin e përhapur aty e këtu lidhur me ndonjë ide momentale të uljes së pagave në sektorin publik.



Në pjesën e fundit të këtij takimi është bashkëbiseduar edhe për trajnimet nga larg që kanë nisur të mbahen fillimisht me kolegët tanë nga komuna e Novobërdës e që do të vazhdojnë edhe me kolegët tanë kudo në Kosovë.



Takime nga larg edhe me Këshillin Drejtues të SBASHK-ut **Përkushtim dhe angazhim në shërbim të arsimit**




Pasi kanë përfunduar takimet nga larg me Kuvendet e Sindikatave të Arsimit Parauniversitar nga të gjitha komunat e Kosovës është mbajtur takimi nga larg me anëtarët e Këshillit Drejtues të SBASHK-ut me qëllim që bashkërisht të analizohet situata aktuale në arsim

dhe të vlerësohen raportet nga takimet me kolegët tanë kudo në Kosovë, që po bëjnë gjithë angazhimet në rrjedhën e mbarë të mësimin në distancë.

Duke hapur këtë takim nga larg kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj ka përshëndetur anëtarët e Këshillit Drejtues dhe kryesinë duke shprehur edhe me këtë rast mirënjohje për angazhimet e stafit qendror e veçmas të menaxherit për financa e administratë e koordinator për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, i cili po vazhdon me përkushtimin në realizimin e detyrave të përditshme sindikale, por edhe në realizimin e takimeve të shumta nga larg. “Vlerësohet me të drejtë se punëtorët e arsimit kudo në Kosovë janë të përkushtuar dhe po punojnë në realizimin sa më të mirë të mësimin nga larg dhe se vazhdon me sukses edhe komunikimi me prindër dhe nxënës. Janë cekur edhe ca vështirësi të vogla që paraqiten në këtë përpjekje. Të nderuarit kolegë me vlerësimet dhe me vendimet nga ky takim do të informoj edhe MASHTI-n, gjegjësisht Ministria Hykmete Bajrami me qëllimin e vetëm që të tejkalohen këto vështirësi brenda mundësive të institucioneve komunale.”, është shprehur kryetari Jasharaj.



takim janë shtruar edhe ca pyetje, të cilat kanë marrë përgjigje nga anëtarët e stafit qendror.



Kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Universiteteve dhe anëtar i Kryesisë së SBASHK-ut, Bardh Bardhi duke bashkëbiseduar me anëtarët e Këshillit Drejtues ka pasqyruar angazhimet e vazhdueshme që po bëhen nga të gjithë në Universitetet e Kosovës. Në këtë

SBASHK-u i drejtohet për të dytën herë Kryeministrit Kurti Ata që e nisen edhe ta përfundojnë mësimin nga larg



Si gjithmonë, edhe në këtë situatë të vështirë e të krijuar nga Corvid-19, SBASHK-u ka dëshmuar me angazhime të sinqerta e konkrete përkushtimin në shërbim të arsimit në Kosovë. Në kuadër të këtij përkushtimi stafi qendror i SBASHK-ut bashkë me veprimtarët kudo në komuna të Kosovës dhe Universitetet ka mbajtur takime me kolegët tanë, që janë përfaqësues të të

gjitha institucioneve arsimore, duke i inkurajuar ata që të vazhdojnë me angazhimet për rrjedhën e mbarë të mësimin nga larg. Në këto takime janë nxjerr vlerësime konkrete dhe është vlerësuar me argumente se falë përkushtimit të punëtorëve arsimor mësimi dhe ligjëratat nga larg po zhvillohen sipas dinamikës së paraparë dhe me plot sukses. Po nga këto takime SBASHK-u ka marrë edhe ide e detyra konkrete, të cilat ka bërë angazhime t'i realizojë dhe një nga to

është që punëtorët e arsimit që kanë mbushur moshën e pensionimit të vazhdojnë me punën e angazhimet në procesin mësimor nga larg sepse për këtë ka argumente të qëndrueshme e në shërbim të procesit mësimor. Për këtë SBASHK-u ka informuar edhe Ministren e MASHTI-t dhe Kryeministrin në detyrë. Në kërkesën e SBASHK-t drejtuar Kryeministrit Kurti, veç tjerash thuhet:

“SBASHK-u ka marrë obligim nga anëtarësia, që edhe një herë, t’i drejtohet Kryeministrit, z. Albin Kurti me kërkesën konkrete që Qeveria të marr një vendim për t’u lejuar punëtorëve të arsimit që kanë arritur moshën e pensionimit të vazhdojnë angazhimin deri në përfundim të procesit mësimor nga larg. Duke e argumentuar këtë kërkesë SBASHK-u cek se procesi mësimor nga larg është duke u zhvilluar dhe se punëtorët e arsimit kanë krijuar një përvojë të mirë të realizimit të procesit mësimor me platformat gjegjëse dhe po mbajnë edhe komunikim të vazhdueshëm me nxënës e prindër duke ua angazhuar bashkërisht për rrjedhën e mbarë të mësimin në distancë. Nëse pensionohen kuadrot arsimore që kanë plotësuar moshën do të vështirësohej rrjedha e mësimin nga larg ngase në këto rrethana procesi i rekrutimit të

kuadrove të reja është tepër i vështirë dhe do të humbeshin ditë të tëra në pritje të afateve të konkursit dhe po ashtu do të kishte probleme në organizimin e punës së paneleve të intervistimit me shkrim e me gojë për kandidatët që konkurrojnë. Po ashtu do kujtuar faktin se kuadrot e reja do ta kishin tepër të vështirë të angazhoheshin suksesshëm në procesin mësimor nga larg ngase do të ishin të panjohur për kolegët në atë shkollë e aq më shumë për nxënësit me të cilët do të duhej ta zhvillonin procesin mësimor. Po ashtu ata do ta kishin tepër të vështirë të krijojnë mundësi për komunikim me prindërit “.

Duke argumentuar me fakte kërkesën SBASHK-u ka kujtuar Qeverinë se të gjithë ata që janë pensionuar nga 1 prilli 2020 deri me sot janë duke mbajtur procesin mësimor me nxënësit e tyre dhe këta mësimdhënës kanë kontribuar mbi 40 vite në sistemin arsimor të Kosovës dhe këtë muaj rrezikojnë të mbesin edhe pa paga edhe pa pensione për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia, pasi që në këto rrethana as nuk kanë marrë vendime të pensionit e as nuk kanë aplikuar për pensione, por janë duke vazhduar punën e mësimdhënësit nga largësia si të gjithë mësimdhënësit tjerë.